

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

07 Mars 2017

Workshop me temë “Paragjykimet e pandërgjegjshme”



Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me FASTIP-in dhe në kuadër të Javës Nderkombëtare të Gruas (International Women's Week), Vodafone Albania zhvilloi një workshop me studentë të FASTIP-it. Workshopi me temë “Paragjykimet e pandërgjegjshme” u zhvillua pranë mjediseve të FASTIP-it me datë 7 Mars 2017.

Përfaqësuesi i kompanisë Vodafone Albania, Z. Spartak Alibali prezantoi për studentët aspekte të ndryshme të paragjyqimeve të pandërgjegjshme që cdo individ bën si në rrethin miqësor, ashtu edhe në ambientin e punës apo të shkollës.

Në fillim çdo student shkruajti në një letër nivelin e paragjyqimit që ato mendonin se bënin në lidhje me të tjerët, në një shkallë nga 1 në 10. Këto shënime u mbajtën deri në fund të workshopit për të parë se sa realist ishte gjykimi i tyre për nivelin e paragjyqimit që ato kanë.

Gjatë workshopit studentët patën mundësi të shprehnin mendimet e tyre në lidhje me temën. Gjithashtu u organizuan disa “lojra” për të nxjerrë në pah se pavarësisht mendimit të ndërgjegjshëm njerëzit mund ti paragjykojnë të tjerët edhe pa e kuptuar. Çdo studenti ju dha një fletë ku duhet të shkruanin emrat e tre personave më të afert të cilëve u besonin më shumë, duke përfshirë anëtarët e familjes. Më tej duhet të shkruanin gjininë dhe moshën e këtyre personave të besuar. Nga të dhënat rezultoi se, ashtu siç pritej, çdo student kishte më shumë besim dhe shoqërohej me shumë me individë të së njëjtës gjini dhe të së njëjtës moshë.

Duke parë rezultatet e këtyre “lojrave” studentët pjesëmarrës kuptuan dhe provuan se si edhe ato vetë paragjykojnë të tjerët në mënyrë të pandërgjegjshme. Këto paragjyqime mund të jenë si me bazë gjinore ashtu edhe raciale, të moshës, të aftësive etj.

Ky workshop, që prej dy vitesh është bërë traditë për studentët e FASTIP-it, u prit shumë mirë nga çdo pjesëmarrës, dhe të gjithë studentët u shprehën të kënaqur për prezantimin dhe rezultatet e marra.

